

# BULETIN №2

## UJI I KOSOVËS

#ujëpërkosovën

Marrëveshja për krijimin e një programi të ri master për menaxhimin e integruar të resurseve ujore në Kosovë

Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina' dhe Programi 'Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë' (IWRM-K) i financuar nga Zvicra, më 20 tetor 2021, kanë nënshkruar Letër-Marrëveshjen për zbatimin e një programi të ri master për 'Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (PM-MIRU)'.

PM-MIRU do të organizohet nga Universiteti i Prishtinës 'Hasan Prishtina' (UPHP) në partneritet me Universitetin 'Haxhi Zeka', në Pejë dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë.



# EDITORIAL



**LAURENT TORCHE**  
ZËVENDËSDREJTOR I ZYRËS ZVICERANE PËR  
BASHKËPUNIM - KOSOVË



**ARDIANA EFENDIJA ZHURI**  
ZYRTARE E LARTË E PROGRAMIT KOMBËTAR / ZYRA  
ZVICERANE PËR BASHKËPUNIM - KOSOVË

## NGRITJA E MARËDHËNIEVE KOSOVARO- ZVICERANE NË NIVEL MË TË LARTË

Duke u mbështetur në marrëdhëniet dypalëshe miqësore dhe bashkëpunimin e rëndësishëm me dekada, Zvicra është zotuar të mbështesë një program të ri shumëvjeçar, shumëmillionësh për "Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë" (MIRU-K). Programi do të luajë një rol kyç në ndërtimin e progresit të shkëlqyer të arritur deri më tani në sigurimin e ujit të sigurt për popullin e Kosovës përmes një sërë iniciativash të tjera të mbështetura nga Zvicra.

Programi i ri fillon si udhërrëfyes ambicioz për transformimin e mënyrës së menaxhimit të resurseve ujore në vend, duke vodosur një theks të mirëbalancuar në nevojat e rritjes ekonomike, objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe konsideratat socio-kulturore. Vodosja e institucioneve dhe popullit të Kosovës në qendër të hartimit të Programit tonë nënkuption që tashmë janë të pranishme kapacitetet e konsiderueshme brenda vendit dhe se shoqëria është e gatshme për gjeneratën e re të iniciativave transformuese të orientuara drejt rezultateve.

Në një kontekst të tillë, Zvicra ofron fonde jashtëzakonisht të rëndësishme, si dhe njohuri mbi konceptet dhe qasjet më moderne për menaxhimin e resurseve ujore, të akumuluara gjatë përvojës shumëvjeçare. Mbi të gjitha, programe të tillë shërbejnë si kanale për shpërndarjen e vlerave zvicerane kur bëhet fjalë për vlerësimin e resurseve natyrore dhe standardeve të larta në mbrojtjen e mjedisit.

MIRU-K është një nga nismat kryesore zvicerane në Kosovë, suksesi i së cilës do të varet në masë të madhe nga përfshirja e shumë palëve të interesit – institucioneve, OShC-ve, donatorëve dhe projekteve të tjera, si dhe popullit të Kosovës. Jemi shumë të lumtur që mbështesim krijimin e një buletini të tillë, i cili synon të ofrojë hapësirë për shkëmbimin e ideve, iniciativave dhe rezultateve në adresimin e sfidave më urgjente të ujit të Kosovës ndërmjet palëve të interesit.

Në fund, i falënderojmë partnerët dhe përkrahësit e shumtë këtij programi në Kosovë, Zvicër dhe jashtë saj, dhe i urojmë Gëzuar Vitin e Ri, shumë suksese dhe një të ardhme të qëndrueshme (të ujtit).

# SKAT CONSULTING – KATËR DEKADA PËRKUSHTIM NDAJ SEKTORIT TË UJIT

Skat Consulting Ltd. është një qendër e resurseve dhe kompani konsulencë e pavarur zvicerane. Që nga viti 1978, Skat ka ofruar ekspertizë teknike, menaxhim dhe mbështetje metodologjike për projekte, programe dhe institucionale ndërkombëtare në një larmi të madhe vendesh dhe për një shumëllojshmëri të madhe klientësh. Gjatë katër dekadave të fundit, Skat Consulting ka evoluar nga një shoqatë e vogël, si pjesë e Universitetit të St. Gallen, Zvicër, në një kompani udhëheqëse zvicerane e drejtuar nga pronarë të specializuar në bashkëpunimin ndërkombëtar.



Me selinë e saj në St. Gallen, Skat Consulting ka zgjeruar me sukses angazhimin e vet ndërkombëtar në Afrikë, Amerikën Latine, Evropën Lindore, Azinë Qendrore, Lindjen e Mesme dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke angazhuar rreth 20 persona në zyrën qendrore dhe rreth 100 punonjës në terren që punojnë kudo në rajone. Skat Consulting është e përkushtuar për të vënë në disposicion shërbimet bazë dhe për të garantuar kushte dinjitoze jetese dhe një mjeshtësi të shëndetshëm për të gjithë. Misioni i saj është të mbështesë qeveritë, sektorin privat dhe shoqërinë

civile anembanë globit në përmirësimin e jetës së njerëzve duke lehtësuar zgjidhje të qëndrueshme në Ujë, Kanalizim dhe Higjenë, Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore (IWRM), Energji dhe Klimë, Ndërtesa dhe Vendbanime, dhe Qeverisje.

Skat Consulting ofron shërbime në nivele teknike, menaxheriale, konceptuale dhe strategjike, duke përfshirë: mbështetjen dhe zbatimin e projekteve dhe programeve; mbështetjen, trajnimin dhe mentorimin e palëve të interesit; ofrimin e këshillave teknike dhe mbështetjes së ekspertëve; lehtësimin e dialogut të politikave dhe zhvillimit të strategjisë; kryerjen e vlerësimeve dhe monitorimit.

Kompania ka një histori dhe përvjetorë të gjerë në zbatimin e mandateve afatgjata për projekte zhvillimore në vendet në tranzicion dhe ato në zhvillim, si Kosova, Moldavia, Ukraina, Taxhikistani, Rajoni i Liqeneve të Mëdha në Afrikë dhe të tjera.

Skat Consulting, që nga viti 2007, është përfshirë në angazhime të ndryshme institucionale dhe të zhvillimit të kapaciteteve në Kosovë, duke ofruar shërbime për dizajnimin dhe performancën e Programit për Mbështetjen e Ujit dhe Kanalizimeve Rurale të financuar nga Zvicra (RWSSP). Kjo nënkuption, ndër të tjera, asistencën e Autoritetit Rregullativ të Shërbimeve të Ujit (ARRShU) në forcimin e kapaciteteve dhe zbatimin e funksioneve të tij; asistimin e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHPK) në përmirësimin e menaxhimit të të dhënave; dhe krijimin e një mëkanizmi raportues publik dhe të Komisionit Evropian për cilësinë e ujit të pijshëm.

Skat Consulting më tej ofroi mbështetje të financuar nga Zvicra (2009-2020) për këshilltarët e Këshillit Ndërmistror të Ujérave (KNU) për koordinimin e sektorit, reformave dhe politikave në nivelet më të larta.

Në vitin 2019, Skat Consulting, në bashkëpunim me Agjencinë Austriake të Mjedisit (AAM), iu dha mandati për të bashkë-dizajnuar dhe ekzekutuar Programin e Menaxhimit të Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë Faza 1 nga SDC (maj 2020 - prill 2024).

# Agjencia Austriake e Mjedisit - Përvojë e gjatë dhe angazhim në vendosjen e standardeve të larta evropiane

## Mbrojtja e ujit nuk njeh kufij

Agjencia Austriake e Mjedisit (AAM) ka forcuar mbrojtjen e ujit në vendet e reja anëtare dhe vendet kandidate për në BE për shumë vite. AAM mund të tregojë për projekte të suksesshme në më shumë se 60 vende - nga vendet anëtare të BE-së në Ballkanin Perëndimor, Lindjen e Mesme, Magreb dhe Az. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë një rajon prioritar për projekte të përbashkëta.

EAA ka disa vite që e mbështet Kosovën në përshtatjen me standardevropiane për mbrojtjen dhe përdorimin e ujit, ajrit, biodiversitetit, apo në trajtimin e çështjes së ndryshimeve klimatike. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i njohurive ndërmjet ekspertëve kosovarë dhe atyre të EAA bëhet në kuadër të projekteve, por edhe gjatë disa viteve në grupet ndërkombëtare të punës, si ato të Agjencisë Evropiane të Mjedisit apo Eurostat.

## Agjencia Austriake e Mjedisit: Këshilltar mjedisor i kërkuar ndërkombëtarisht

Agjencia Austriake e Mjedisit është institucioni me numrin më të madh të eksperteve për mjedis në Austri dhe një nga konsulentët kryesorë mjedisore në Evropë. Ekspertët nga mbi 55 fusha punojnë së bashku nën ombrellën e AAM-së. Puna ndërdisiplinore është pjesë e jetës së përditshme në AAM-së, me fokus të aktiviteteve këshilluese në konsulencën mjedisore dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale. Laboratori i AAM-së luan një rol udhëheqës në zhvillimin e metodave të reja të analizës së ujit. Në bashkëpunim me ekspertët e ujit, ekipi i Teknologjisë Informativë zhvillon sisteme të personalizuara të bazës së të dhënave për klientët tanë.

Temat qendrore të programit MIRU-K, të tillë si krijimi i metodave për mbrojtjen e resurseve ujore nëntokësore ose zhvillimi i zgjidhjeve për një sistem informacioni për ujin - janë detyra thelbësore të ekspertëve të ujit të AAM-së. E shoqëruar me më shumë se 30 vjet përvojë në konsulencën mjedisore, kjo njohuri është e kërkuar ndërkombëtarisht.

## Baza e përbashkët: Ligji i BE-së për ujërat

Një avantazh i madh është se menaxhimi i ujit në Kosovë dhe Austri ndajnë të njëjtën bazë ligjore: legjislacionin e BE-së për ujërat dhe, në veçanti, Direktivën Kornizë të BE-së për Ujërat. Si rezultat, mësimet e nxjerra në Austri gjatë zbatimit mund të komunikohen dhe transmetohen në mënyrë efektive në Kosovë, duke ju përshtatur kushteve lokale.

Programi MIRU-K përdor qasjen 'profesionisti për profesionist' si një teknikë metodologjike për transferimin dhe mbështetjen e njohurive. Fokusi është në zhvillimin e përbashkët të mundësive nga ekspertët kosovarë dhe ata të AAM-së për zgjidhjen e problemeve aktuale. Përvoja praktike dhe zbatimi në situata aktuale kanë përparësi ndaj mësimeve teorike. Hapat e parë të përbashkët, në fazën e parë të zbatimit të programit MIRU-K, janë premtues dhe jatin perspektiva të mira që të mund të arrihen qëllimet e tij.

# STUDIMI I BILANCIT UJOR PËR KOSOVËN – NJOHURI TË REJA PËR VENDIMMARRJE MË TË MIRE

Programi IWRM-K prezantoi Studimin e Bilancit Ujor para përfaqësuesve të Ministrisë. Ky është hulumtimi i parë gjithëpërfshirës i këtij lloji në nivel kombëtar dhe do të ofrojë informacionin e mëposhtëm për palët e interesit të ujit në Kosovë:

- një kuptim më i mirë i stresave të lidhura me sasinë e ujit nëpër pelljet kryesore të lumenje të Kosovës;
- baza e zgjeruar e njojurive dhe një kuptim më i mirë i prioriteteve në lidhje me aspektet sasiore të menaxhimit të integruar të resurseve ujore (p.sh. alokimet e ujit në hapësirë dhe kohë duke marrë parasysh priorititet socio-ekonomike dhe të mbrojtjes mjedisore, duke përfshirë flukset mjedisore);
- përmirësimi i të kuptuarit të ekonomisë kryesore të resurseve ujore për Kosovën.

Studimi kombinon analizat e të dhënave të resurseve ujore (p.sh. disponueshmëria dhe kërkesa/përdorimi) dhe vlerësimi i stresit të ujit (p.sh. përcaktimi sasior i (mos)përputhjes midis disponueshmërisë dhe kërkësës), të gjitha në kontekstin e skenarëve të ndryshimeve klimatike.

Përgatitja e studimit u bazua në mbledhjen dhe sintezën e gjerë të të dhënave në databazat me përdorim të shumëfishtë mbi meteorologjinë, hidrologjinë dhe përdorimin e ujit. Modele të avancuara si SWAT, HEC-HMS dhe WEAP, u përdorën gjithashtu për përgatitjen e hulumtimit. Të gjitha këto mund të përdoren si sisteme dhe mjete mbështetëse të vendimmarrjes nga autoritetet përkatëse në të ardhmen.

Për të plotësuar boshillëqet kryesore të të dhënave, studimi u mbështet në përdorimin e të dhënave të sensorit në distancë nga platforma të ndryshme satelitore. Të dhënat e përditësuara ofrojnë të dhëna të besueshme për të bërë parashikime më të sakta të disponueshmërisë së burimeve ujore në lidhje me skenarët e mundshëm të ndryshimeve klimatike për rajonin.

Sipas Indeksit të Mungesës së Ujit (Falkenmark dhe Lindh, 1974), të gjitha pelljet e tjera lumore janë nën stres ujor, me përjashtim të pellgut të lumit Drini i Bardhë. Gjendja në pellgun lumor të Moravës së Binçës është shqetësuese, ashtu si edhe situata në pellgun e lumit Ibër, e cila mund të klasifikohet si mungesë uji si rezultat i ndryshimeve klimatike.

Për më shumë informacion mbi studimin, ju lutemi shkruani në: [kosovo@skat.ch](mailto:kosovo@skat.ch)



## EDUKIMI MBI UJIN PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË

Në mbështetje të Programit Master në IWRM-K, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) do të sigurojë një grant prej 150,000 €. Financimi i vënë në dispozicion përmes Programit IWRM-K do të përdoret nga universiteti nikoqir dhe ai partner për të ndërtuar kapacitetet e nevojshme për organizimin e suksesshëm të programit të studimit.

"Kemi nderin ta themelojmë këtë partneritet të veçantë, i cili do të rezultojë me një kurrikulë moderne. Ky program do t'u ofrojë profesionistëve të sektorit të ujërave në Kosovë dhe më gjerë njoħuri dhe shkathtesi të nevojshme për t'i adresuar sfidat e ardhshme në menaxhimin e ujërave të shoqërisë sonë, duke marrë parasysh ndryshimet e vazhdueshme globale të paprecedentë", tha Prof. Naser Sahiti, Rektor i Universitetit të Prishtinës 'Hasan Prishtina.'

Në ceremoninë e nënshkrimit mori pjesë z. Laurent Torche, Zëvendës Drejtor i Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim. Ai tha: "Këtë program master e shohim si një nga investimet më të rëndësishme zvicerane në sektorin e ujit në Kosovë. Është një investim për të ardhmen e Kosovës dhe veçanërisht për të rinjtë që do të jenë në gjendje të marrin përgjegjësi në menaxhimin e burimeve ujore bazuar në aftësitë dhe praktikat më të mira".

Studimi master do të krijohet dhe akreditohet gjatë 1-2 viteve të ardhshme, pas së cilës do të fillojë pranimi i studentëve të parë që do të bëhen specialistë në menaxhimin e burimeve ujore të Kosovës.

### PROGRAMI I TRAJNIMIT IWRM-K: VENDOSJA E BAZAVE PËR ZHVILLIMIN AFATGJATË TË NJOHURIVE DHE AFTËSIVE NË MENAXHIMIN E BURIMEVE UJORE NË KOSOVË



Me qëllim të forcimit dhe aplikimit të qasjes moderne për ndërtimin e kapaciteteve në menaxhimin e burimeve ujore, Programi IWRM-K hyri në partneritet me Institutin Kosovar për Administratë Publike (IKAP) përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit (MM).

Memorandumi i Mirëkuptimit përcakton kornizën e bashkëpunimit dhe ndarjen e përgjegjësive ndërmjet palëve në përpjekjet e përbashkëta për të zhvilluar dhe zbatuar Programin e Trajnimit për IWRM (TP-IWRM), duke synuar administratën shtetërore/shërbyesit civilë të Kosovës dhe profesionistët e tjera të ujit.

Konsulentët ndërkombëtarë të kontraktuar (Deltas, Holandë), pas një vlerësimi të nevojave për trajnim, identifikuani temat dhe subjektet kryesore që do të përfshiheshin në TP-IWRM. Doli se theksi vihet më shumë në qëndrueshmërinë, shpérndarjen dhe menaxhimin e burimeve ujore për përdorim dhe mbrojtje efikase të ujit, me përmirësimin e politikave ujore, legjislacionit, gjinisë, pjesëmarrjes së njerëzve dhe menaxhimit të informacionit. Duke iu referuar disa programeve të trajnimit në mbarë botën, kurikula TP-IWRM është finalizuar dhe është e përshtatshme për rrethanat e vendit. Pedagogjia e TP-IWRM përfshin sesione leksionesh, mësime, analiza rasti studimore, lojëra me role dhe video të ndjekura nga diskutimet në grup mbi temat e sektorit të ujit si dhe vizita në terren. Një trajnim i trajnerëve do të mbahet në fillim të vitit të ardhshëm.

# Partneriteti ndërmjet Profesionistëve të Rinj të Ujit në Kosovë (YWP-K) dhe Programit IWRM-K

Memorandumi i Mirëkuptimit (MM) i nënshkuar ndërmjet Programit dhe SHUKOS/ Grupi i të Rinjve Profesionistë të Ujit në Kosovë (YWP-K) ofron drejtimin strategjik për ndërtimin e një partneriteti afatgjatë përmes investimeve të synuara në kapacitetin e profesionistëve të ardhshëm të ujit në Kosovë. Mbështetja e programit deri më tani përfshin Strategjinë dhe Programin e Punës për YWP-K (2022-2024) dhe Rregulloren e Brendshme.

Këto dy dokumente të rëndësishme strategjike/rregullative përcaktojnë vizionin, misionin dhe veprimet përkatëse prioritare, të cilat pasqyrojnë gjithashtu angazhimin e tyre më të madh ndaj agjendës së IWRM të vendit dhe rregullave të brendshme që do të ndihmojnë në arritjen e misionit YWP-K.

Bashkëpunimi pritet të zgjerohet më tej përmes pjesëmarrjes aktive të YWP-K në aktivitete të ndryshme të Programit, siç janë trajnimet dhe aktivitetet e projekteve të mbështetura nga grantet.

## Përmirësimi i procedurave të lejeve një hap i rëndësishëm drejt transparencës më të madhe të MMPHI

Gjatë vitit 2021, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) ka bërë progres të rëndësishëm në përmirësimin e procedurave të lejeve të ujit. MMPHI ka krijuar një sistem të posaçëm përcjellës për aplikimet për leje dhe ka punuar në përmirësimin e mekanizmave të koordinimit të brendshëm për një dhënie më efikase të lejeve.

I gjithë ushtrimi përfshinte hartimin e procedurave dhe identifikimin e pengesave (si për aplikantët ashtu edhe për administratën), përditësimin e bazave të të dhënave të kërkesave për leje dhe strategjinë e mbështetjes së ardhshme të ekspertëve për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin e lejeve. Procesi ka rezultuar në vizualizimin e procedurave dhe dokumenteve udhëzuese hap pas hapi që duhet ta bëjnë më të lehtë për operatorët përbushjen e kërkesave për marjen e lejeve të nevojshme.

Bazuar në rezultatet e deritanishme, MMPHI do të vazhdojë të përmirësojë sistemin duke angazhuar ekspertizën e nevojshme teknike, duke ofruar dokumente më specifike udhëzuese për operatorët se si të përmirësojnë më tej cilësinë e aplikacioneve dhe duke rritur më tej kapacitetin zbatues. E gjithë reforma është motivuar nga kërkesat e operatorëve, si dhe nga synimi i Ministrisë për të përmirësuar transparencën e punës së saj.

## MBËSHTETJE PËR SISTEMIN INFORMATIV UJOR (SIU)

Programi IWRM-K ka hartuar një Udhërrëfyes gjithëpërfshirës për Zhvillimin e Mëtejshëm të Platformës së Menaxhimit të Informacionit të Ujit për MMPhi. Ky udhërrëfyes është vërtetuar nga Grupet e Punës përkatëse.

Udhërrëfyesi synon të shërbejë si një dokument udhëzues, duke identifikuar hapat kyç për zbatimin, ndërtimin e aftësive dhe vendosjen e aranzhimeve të qeverisjes për zhvillimin e mëtejshëm të SIU.



Figura: Arkitektura konceptuale e së ardhmes/SIU e përmirësuar siç parashikohet nga Programi

### AKTIVITETET E TRYEZËS SË RRUMBULLAKËT ME PALËT E INTERESIT TË PROGRAMIT

Gjatë nëntorit 2021, me mbështetjen e WWF Adria, Programi IWRM-K organizoi një sërë tryezash të rrumbullakëta me palë të ndryshme të interesit nga pellgjet e lumenjve Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenci. Qëllimi i këtyre sesioneve ishte prezantimi i aktiviteteve të Programit, propozimi i modeleve për ngritjen e Mekanizmit të Pjesëmarrjes Shumëpalëshe dhe adresimi, konsultimi dhe avancimi i procesit për menaxhimin më të mirë të resurseve ujore, duke përfshirë edhe planet e menaxhimit të pellgjeve lumore.

Tryezat e rrumbullakëta kanë mbledhur së bashku kryesisht përfaqësues nga komunat dhe OSHC/OJQ-të, por gjithashtu grupe joformale, aktivistë të mjedisit, bujqë, biznese dhe grupe apo individë të tjerë të interesuar të lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me sektorin e ujit në Kosovë.

Gjatë tryezave të rrumbullakëta, Programi mundësoi diskutime tematike dhe shumë të hapura për të kuptuar më thollë nevojat, opinionet dhe idetë e grupeve shumëpalëshe të interesit. Përveç kësaj, Ekspertët e Programit ofruan planprograme trajnimi për të gjitha palët e interesit si dhe informacion mbi skemën e granteve për OSHC-të, e cila pritet të zbatohet në dy vitet e ardhshme.

Programi IWRM-K, së bashku me WWF Adria, do të vazhdojë bashkëpunimin e ngushtë me MMPhi, veçanërisht me Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore, për të finalizuar modelin më të pranueshëm të pjesëmarrjes së palëve të interesit në IWRM, me objektivin për të siguruar përfshirjen efektive dhe gjithëpërfshirëse të të gjitha palëve të interesit lidhur me menaxhimin e ujërave në tre pellgjet lumore.



# VATRA E TË RINJVE DHE ENTUZIASTËVE TË MJEDISIT

## OJQ - EKOvizioni

OJQ Ekovizioni është themeluar në vitin 2004 dhe operon kryesisht në komunën e Podujevës. Janë rreth 60 projekte të ndryshme nga donatorë vendas dhe ndërkombëtarë që karakterizojnë portofolin e Ekovizonit. Duke qenë dëshmitar të përkeqësimit të situatës mjedisore, Ekovizioni është vazhdimisht i përkushtuar për të përmbushur vizionin e vet: **Kosova me mjedis të pastër dhe me vetëdije të qytetarëve për ruajtje të mjedisit, në përputhje me standarde evropiane.**

Drejtori Ekzekutiv i Ekovizonit, z. Shpend Sopa, përshkruan hapat gradual të shtrirjes së veprimtarisë së organizatës jo vetëm në komunën e Podujevës, por në gjithë territorin e Kosovës. Vendimi për zgjerimin e aktiviteteve të organizatës në komuna të tjera erdhi si rezultat i mungesës së OSHC-ve në nivel lokal që merren me mbrojtjen e mjedisit dhe mos adresimit të zërit të qytetarëve për zgjidhjen e problemeve. Janë tre shtylla kryesore mbi të cilat operon Ekovizioni, konkretisht politika mjedisore, menaxhimi i mbeturinave dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Kur është fjala për hidrografinë e komunës së Podujevës, z. Sopa me krenari përmend lumen Llap, i cili buron në këtë komunë me një gjatësi prej 61 kilometrash, ose gjithsej 82,7 kilometra deri në grykëderdhjen e lumit Sitnica. I gjithë rrjeti hidrografik i komunës së Podujevës i derdh ujërat në drejtim të pellgut të Detit të Zi. Shqetësimi i zotit Sopa shihet kur flet për ndotjen e ujit, e cila kryesisht ndodh nga derdhja e ujërave të zeza të patrajuara në shtratin e lumenjve, si nga amvisëria dhe bizneset, ashtu edhe nga industria.

Edhe pse Ekovizioni ka realizuar disa projekte që lidhen drejtpërdrejt me ujin, megjithatë, sipas z. Sopa, mbështetja e donatorëve për projektet e ujit, e cila deri më tanë ka qenë e vogël, duhet të rritet. Projektet afatgjata të menaxhimit të resurseve ujore dhe mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi do të kishin qenë një ndihmë e madhe në krijimin e politikave dhe programeve mjedisore më të avancuara në mbrojtjen e mjedisit. Në të njëjtën kohë, kjo mbështetje e donatorëve do t'i kishte ndihmuar vetë OJQ-të për të kapërcyer barrierat e luhatjes së stabilitetit financiar të organizatës.



# Për një Kosovë të gjelbër dhe të pastër

## OJQ - Let's Do it Peja

Është pothuajse pothuajse një dekadë që "Let's do it Peja" u themelua si një organizatë me bazë në komunitet e që më vonë u regjistrua si OJQ. Drejtori ekzekutiv i "Let's do it Peja", z. Urim Xheravina, flet mbi përfshirjen e organizatës në realizimin e projekteve dhe aktivitetave të ndryshme nën Misionin **"Avokojmë, Edukojmë dhe Bashkëpunojmë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë"**, duke bashkëpunuar me partnerë dhe donatorë, vendorë dhe ndërkombëtarë. Fokus i aktivitetit të ardhshëm pesëvjeçar të "Let's do it Peja" janë fusha specifike tematike si ajri, uji, toka, mbeturinat, energjia dhe biodiversiteti.

Z. Xheravina thekson se "Let's do it Peja" ka kapacitet dhe ekspertizë për të ndihmuar autoritetet përkatëse në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të resurseve ujore në Kosovë. Për më tepër, kjo përvojë vjen nga projektet dhe aktivitetet e zhvilluara në pellgun e lumit Drini i Bardhë dhe degët e tij. Gjatë monitorimit të gjendjes së rrjedhave ujore në pellgun e Drinit, z.Xheravina konsideron se në pjesën më të madhe lumenjtë janë të ndotur dhe shtretërit të degraduar. Në përgjithësi, gjendja është alarmante jo vetëm në pellgun e lumit Drin por edhe në pellgjet tjera ujore të Kosovës. Një ndotje e tillë mund të haset edhe në pikat më të larta malore në zonat e mbrojtura të Parqeve Kombëtare. Prandaj, është shumë e rëndësishme që OJQ-të të pranohen si partnerë të barabartë nga institucionet përkatëse dhe vazhdimisht të janë aktive dhe të kontribuojnë më shumë në ndërgjegjësimin e publikut.

OJQ-të mjedisore përballen me sfida në mënyra të ndryshme, por sfida më e madhe është qëndrueshmëria organizative dhe financiare për shkak të jetëgjatësisë së shkurtër të projektit me një buxhet relativisht të vogël. Në këto rrethana nuk mund të sigurohet qëndrueshmëria, pasi stafi po ashtu në vazhdimësi është në kërkim të mundësive të tjera të punës qoftë në institucionet shtetërore apo në organizata ndërkombëtare në Kosovë.

Z. Xheravina inkurajon organizatat e shoqërisë civile që merren me çështje mjedisore që të përfshihen sa më shumë në menaxhimin e resurseve ujore të Kosovës. Kjo bëhet brenda mundësive të tyre njerëzore, organizative dhe financiare, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse dhe duke krijuar kështu partneritete për të mirën e publikut të gjerë. Kjo përfshin sigurimin e ujit të pastër për pije, mbijetesën e biodiversitetit, bujqësinë dhe blektorinë si dhe aktivitete të tjera ekonomike.



## STRATEGJIA DHE PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE HIDROMETEOROLOGJIKE NË KOSOVË



Qasja drejt një vizioni të qartë për zhvillimin e shërbimeve hidro-meteorologjike të Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse në fokus ka sjellë nevojën për hartimin e një strategjie që do të kontribuojë në sigurinë dhe mirëqenien e njerëzve, zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit brenda Kosovës dhe vendet fqinje.

Nevoja për këtë strategji bazohet në një sërë dokumentesh ligjore duke filluar nga Ligji për Veprimtaritë Hidrometeorologjike (Ligi Nr. 06/I-035), Strategjia e ndryshimeve klimatike 2019-2028 etj, duke marrë parasysh edhe synimin e Kosovës për t'iu bashkuar Organizatës Botërore Meteorologjike (OBM) si anëtare me të drejta të plota .

Strategjia është duke u zhvilluar në bashkëpunim me ekspertizën ndërkombëtare dhe vendore, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK) dhe GIZ. Strategjia, ndër të tjera, synon rritjen e kapaciteteve teknike dhe institucionale të IHMK-së për të përmbushur standartet e përcaktuara nga OBM-ja, ndërkohë që synon të lidhet me shërbimet hidrometeorologjike ndërkombëtare për përmirësimin e të dhënave.

Strategjia mbështetet nga Programi "Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Menaxhimi i Përmbytjeve në Ballkanin Perëndimor", financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe zbatuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

# #POSTIMETNËRRJETE SOCIALE



Së bashku me rininë krijojmë të ardhmen e menaxhimit të ujërave 😊  
Angazhimi i të rinjëve me pakëz inovacion & empati, kanë qenë përbërësit kryesor për të lëvizur drejt një bote me ujë të sigurtë për të gjithë.

Përparimi në 2021 dukej si 🖐

#GWPAtAGlance

Ujërat nëntokësore ofrojnë një 'zgjidhje natyrale' për përshtatjen ndaj ndryshimeve. Menaxhimi i ujërave nëntokësore ka nevojë për "ri-vlerësim strategjik" për të siguruar burime të mjaftueshme në një të ardhme të pasigurt.



#WorldWaterDay

## Ky **BULETIN**

Mbështetet nga programi IWRM-K i SDC-së i bashkëfinancuar nga Qeveria e Kosovës dhe zbatuar nga Skat Consulting Ltd., St. Gallen, Zvicër dhe Agjencia Austriake e Mjedisit (EAA).

Nëse dëshironi të shihni videon tonë promovuese, klikoni [këtu](#):



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC

**skat** Swiss Resource Centre and  
Consultancies for Development



Integrated Water Resources  
Management in Kosovo



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

ENVIRONMENT  
AGENCY AUSTRIA **umweltbundesamt**

## Na ndiqni

Facebook: iwrn\_k Instagram: iwrn\_k  
linkedin: iwrn\_k twitter: iwrn\_k

[www.iwrn-k.com](http://www.iwrn-k.com)

## Na kontaktoni

Skat Consulting Ltd.  
Menaxhimi i Integruar i  
Burimeve Ujore në Kosovë  
Rruga Pashko Vasa 136  
Kati I. Nr.5, Pejton  
Prishtina, Kosovë  
Email: [kosovo@skat.ch](mailto:kosovo@skat.ch)